

VENDIM
Nr. 227, datë 23.4.2014

PËR MBYLLJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NJU-JORK DHE HAPJEN E ZYRËS KONSULLORE PRANË MISIONIT TË PËRHERSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË NJU-JORK TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
 2. Hapjen e Zyrës Konsullore pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
 3. Vendimi nr. 585, datë 23.8.2006 i Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.
 4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama